



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURAV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 57

Prishtinë, më 18.10.2016, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, N-204

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Valdete Bajrami, Xhavit Haliti, Bislim Zogaj, Fatmir Xhelili, Vjosa Osmani, Arben Gashi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Kujtim Paçaku.

I ftuar: Skender Hyseni, ministër i Punëve të Brendshme.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi Njomza Emini, kryetarja e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 07.10.2016 dhe 11.10.2016;**
- 3. Raportim i z. Skender Hyseni, ministër i Punëve të Brendshme;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 07.10.2016 dhe 11.10.2016;

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të datës 7 tetor 2016 dhe 11 tetor 2016.

3. Raportim i z. Skender Hyseni, ministër i Punëve të Brendshme

Në fillim **kryetarja** e Komisionit i njoftoi të pranishmit se shtyrja e këtij takimi ka qenë me kërkesë të ministrit të Punëve të Brendshme.

Pastaj, ajo e falënderoi ministrin për përgjigjen në ftesën për raportim në Komision, si dhe për gatishmërinë e tij për bashkëpunim.

Ministri Hyseni, para prezantimit të raportit të tij, fillimisht kërkoi ndjesë për shtyrjen e këtij takimi. Me pas prezantoi stafin e tij në këtë ministri me të cilët ishte prezent në këtë takim, dhe tregoi se para takimit kjo ministri ka dërguar një raport me shkrim për Komisionin.

Pastaj, ministri prezantoi raportin e tij, ku tha se Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së është miratuar nga Qeveria e Kosovës në dhjetor 2015 dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është miratuar në mars 2016. Ky program është i obligueshëm për të gjitha institucionet në Kosovë. Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, si i tillë është i ndarë në masa legislative dhe në masa zbatuese. Ndërsa masat zbatuese ndahen në tre pjesë, gjegjësisht në kornizë të politikave, reformë institucionale dhe ngritje të kapaciteteve, si dhe zbatimi në praktikë. Nga këto, Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse e drejtpërdrejtë për zbatimin e 99 masave zbatuese dhe 14 masave legislative, përfshirë këtu të kapitujt tjerë, si kapitulli 2: liria e lëvizjes së punonjësve, kapitulli 3: e drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve, kapitulli 14: politikat e transportit, kapitulli 23: gjyqësori dhe të drejtat themelore, si dhe kapitulli 27: mjedisi. Pra, nga gjithsejtë 113 masave, prej tyre 24 janë të përfunduara dhe 34 janë në fazën e realizimit. Kurse 55 masa adresohen në vazhdimësi dhe raportohen përmes të dhënave statistikore në përdhën e më vonshme.

Megjithatë, ministri u përqendrua te çështjet të cilat dalin nga kapitulli 24, pasi që në raport janë të përfshira kapitujt e tjerë dhe që ky kapitull ka të bëjë me ligjin e ri për azil. Ky projektligj, sipas tij, është finalizuar dhe ndodhet në Ministrinë e Integrimit Evropian për dhënien e opinionit ligjor. Gjithashtu përmendi hartimin e disa projektligjeve, siç është hartimin e ligjit për infrastrukturë kritike, plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për të huajt, dhe projektligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror. Pastaj potencoi nënshkrimin e marrëveshjeve të ripranimit, me Turqinë, Maqedoninë dhe Letoninë. Marrëveshja me Turqinë është nënshkruar në dhjetor të vitit 2015, kurse draft- marrëveshjet me Maqedoninë dhe Letoninë janë finalizuar dhe pritet caktimi i datave për nënshkrimin e tyre. Kurse sa i përket nënshkrimit të marrëveshjeve për bashkëpunim policor, është bërë nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me Lituaninë, ndërsa janë finalizuar dy draft- marrëveshje me Turqinë dhe Estoninë, kurse me Italinë, Belgjikën dhe Danimarkën janë në fazën e negocimit. Gjithashtu MPB-ja është në fazën e negocimit të memorandumit të bashkëpunimit me EUROPOL-in, sepse anëtarësimin në këtë organizatë nuk mund të bëhet pa qenë dhe anëtarë i Bashkimit Evropian. Pastaj, tha se lidhja e marrëveshjes me FRONTEX-in për menaxhimin e integruar të kufirit, është marrëveshja e dytë e rëndësishme që Kosova ka lidhur me Bashkimin Evropian pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim.

Gjatë prezantimit të raportit, ministri raportoi dhe për liberalizimin e vizave, sipas të cilit Kosova ka plotësuar pjesën dërmuese të kriterëve, ku në procesin e liberalizimit të vizave, MPB-ja ka qenë përgjegjëse për zbatimin e shumicës së aktiviteteve të dala nga Udhërrëfyesi për Liberalizim të Vizave, i cili përmbante 95 kriterë, si dhe 164 veprime të dala nga këto kriterë. Prej këtyre, MPB-ja ishte drejtpërdrejt përgjegjëse për përmbushjen e 70 kriterëve dhe 113 veprimeve. Gjatë procesit të përmbushjes së kriterëve, MPB-ja ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e Komitetit Drejtues për Liberalizim të Vizave në nivel politik dhe teknik. Në nivel politik, Ministri i Punëve të Brendshme është bashkë-kryesues i Komitetit Drejtues së bashku me ministrin e Integritimit Evropian. Raporti i katërt dhe final i Komisionit Evropian, i publikuar më 4 maj 2016, i cili ka vlerësuar se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret në Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave dhe i pasuar me propozimin e dhënë për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Dhe po atë ditë, ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës ka qëndruar në Bruksel ku është pritur nga Komisioneri për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi, Dimitris Avramopoulos, ditën e njëjtë kur është shpallur raporti final i cili rekomandon përfshirjen e Kosovës në listën me shtetet të cilat nuk kanë nevojë për viza në zonën Schengen. Raporti gjithashtu thekson se para se propozimi i Komisionit Evropian të miratohet nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, Kosova duhet të ratifikojë marrëveshjen për demarkacionin me Malin e Zi dhe të forcojë historikun e lëndëve (trac-krecord) në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, kriterë këto të cilat nuk janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me MPB-në, por janë kriterë që i ka vendosur Komisioni Evropian. Kurse, sa i përket periudhës pas liberalizimit të vizave, MPB-ja do të ketë rol kyç për zbatimin e kriterëve dhe standardeve që përcaktohen si pjesë të vendimit për heqjen e vizave për Kosovën, sensibilizimi i qytetarëve të Kosovës për lëvizjen pa viza, kushtet dhe kriteret e udhëtimit pa viza, përcjellja e numrit të azilkërkuesve, menaxhimi dhe ruajtja e kufijve, etj.

Kurse, ministri nuk dëshiroi të diskutojë lidhur me kriteret që Kosovës i janë parashtruar, nëse këto kriterë kanë qenë të drejta ose jo, si të tilla. Edhe pse konstatoi se kushtet për Kosovën janë të padrejta, dhe sidomos kushti për miratimin e demarkacionit me Malin e Zi. Ai gjithashtu tregoi për takimin e tij me ministrin e Punëve të Brendshme të Austrisë, dhe i cili ka konfirmuar përkrahjen e vendit të tij për vendimin për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës.

Pastaj, **kryetarja** e Komisionit pas prezantimit të raportit të ministrit, parashtrroi dy pyetje për ministrin. Pyetja e parë, nëse ka mjete buxhetore ose janë siguruar ato mjete për zbatimin e masave që janë në fushë-veprimtarinë e MPB-së? E dyta, cili është bashkëpunimi me ministrinë e tjera të cilat ndajnë bashkëpërgjegjësinë me MPB-në në zbatimin e masave zbatuese të Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së?

Ministri Hyseni, në përgjigje të pyetjes së parë, tha se mjetet buxhetore mungojnë thuajse çdoherë, por ato sigurohen pas një manipulimi me fondet të cilat ekzistojnë për të mbuluar këto masa, dhe sidomos ndihet nevoja për mjete shtesë sa i përket çështjeve të konsulencës më specifike. Kurse sa i përket koordinimit, tha se zyrat për integritet evropian në ministrinë e caktuara dhe në kryeministri koordinohen në baza ditore, sepse së cili është përgjegjës për kryerjen e detyrave të tij. Kurse një ngecje të vogël, sipas tij është sa i përket harmonizimit të planit legjislativ.

Time Kadriaj, ka diskutuar për kriteret e liberalizimit të vizave duke përmendur dhe vizitën e fundit të realizuar nga Komisioni për Integritet Evropian në Gjermani dhe Belgjikë, ku sipas së

cilës kushti kryesor nuk ka qenë vetëm demarkacionin i kufirit me Malin e Zi, por dhe kriteri që ka të bëjë me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kurse nuk u pajtua me ministrin kur tha se për këtë kriter “është kërkuar të forcojë historikun e lëndëve”, por është kërkuar të bëhet luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit si kriter kryesor. Ndërsa sa i përket demarkacionit në Bruksel kanë kërkuar të bëhet demarkacioni pa paragjykuar, të bëhet kjo marrëveshje, ose një marrëveshje tjetër për çështjen e kufirit. Dhe si kriter i tretë dhe që nuk është potencuar është frika nga migrimi, kurse nga MPB-ja ka kërkuar të tregojë se sa është bërë rreth kësaj çështje, pra migrimit.

Ministri Hyseni, duke ju përgjigjur pyetjeve të deputetes, tha se në këtë rast ka përdorur gjuhën e njëjtë të përdorur nga Komisioni Evropian, pra “*trac-krecord*” që në gjuhën shqipe do të thotë me raportuar numra të saktë të lëndëve të përmbyllura në gjykatë me veprime konkrete me vendime gjyqësore të formës së prerë, pra përdorimi i gjuhës së saktë për të shmangur çfarëdo keqkuptimi. Komisionari Avramopoulou tha se është personi kryesor dhe përgjegjës sa i përket liberalizimit të vizave, dhe publikisht ka deklaruar se për Kosovën mbeten të plotësohen dy kushte të tjera, e para demarkacioni dhe e dyta ajo që u potencia rreth korrupsionit dhe krimit. Kurse sa i përket migrimit, Kosova ka arritur rezultate të mira sa i përket menaxhimit të migrimit të paligjshëm, dhe e cila është vlerësuar lart, sidomos nga ato vende të cilat janë goditur nga vala e migrimit të paligjshëm, siç është edhe Austria. Me Gjermanin ka pasur një bashkëpunim të ngushtë, siç dihet ka qenë një nga vendet ku më së shumti është goditur nga vala e migrimit ilegal. Kurse ka pohuar se frika për një migrim të mundshëm është i pranishëm në këto vende dhe këtë frikë nuk mund ta heq askush, sepse këtë frikë e kanë mbështetur shtetet e tjera të rajonit. Ai the se në bazë të takimeve që ka pasur me ministrat e punëve të brendshme të shteteve anëtare të BE-së, gjithmonë e kanë potencuar çështjen e demarkacionit dhe po ashtu këta ministra janë ata të cilët do të marrin vendim në Këshillin e Ministrave të BE-së për çështjen e vizave për qytetarët e Kosovës.

Xhavit Haliti, ka deklaruar se për gjashtë muaj rresht ka munguar ministri të raportojë në këtë Komision.

Ka pasur një ndërhyrje të ministrit i cili ka thënë se është hera e parë që ka pranuar një ftesë me shkrim për raportim në këtë Komision.

Mirëpo, ka vazhduar **Xhavit Haliti**, duke thënë se ministri është ftuar para gjashtë muajsh dhe tashmë ju ka kaluar koha disa çështjeve për të cilat kishte dashur të diskutojë. Megjithatë ai ka diskutuar për disa çështje të brendshme në Kosovë dhe që bien në kompetencë të MPB-së, duke filluar me çështjen e rastit të Kumanovës që ka ndikuar në raportet ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë dhe pyeti nëse MPB-ja ka pasur ndonjë informatë lidhur me organizimin e këtij rasti dhe parandalimin e mundshëm të tij. Kurse pyetja tjetër kishte të bënte me arrestimin e disa imamëve ose predikuesve fetarë dhe akuzimi i tyre për nxitjen e terrorizimit, përkatësisht rekrutimin e njerëzve në luftën në Siri ose rekrutimin e tyre në Kosovë. Ndërsa ka pyetur nëse është ngritur ndonjë aktakuzë ndaj tyre dhe nëse janë argumentuar ato aktakuza? Kurse pyetja tjetër kishte të bënte me luftimin e trafikimit në Kosovë, kryesisht të drogës dhe përdoruesve të saj. Ai u interesua për çështjen që ka të bëjë me ligjin për komunikacionin rrugor dhe rregullimin e sinjalistikës me qëllim të evitimit të pasojave që qytetarët e Kosovës i pësojnë. Ndërsa sa i përket luftimit të trafikimit të njerëzve dhe ushtrimit të prostitucionit në Kosovë, pyeti se çka ka ndërmarrë kjo ministri për të parandaluar këto dukuri dhe të cilat mund të hasen gjithandej nëpër Kosovë? Pastaj në mënyrë të veçantë është mungesa e luftimit të mirëfilltë të kontrabandës

me mallra dhe kontrollet e tyre në kufij. Një çështje tjetër, kërkoj zbardhjen e vrasjeve politike të cilat kanë ndodhur në Kosovë dhe vrasjeve gjithandej nëpër Kosovë. Kurse mbikëqyrja e doganave nga njësitet e specializuara të policisë për evitimin e falsifikimit të mallrave që mund të hyjnë në Kosovë, shprehu shqetësimin e tij, po ashtu. Pastaj sa i përket kontrollit kufitar i cili duhet të bëhet nga policia kufitare sa më mirë që të jetë e mundur, sikurse në rastin e vendeve fqinje, siç është ai me Malin e Zi.

Ministri Hyseni, duke ju përgjigjur pyetjeve të parashtruara, sa i përket ngjarjeve të Kumanovës tha se MPB-ja është kyçur në këtë proces aq sa ka pasur hapësirë për të ndihmuar. Kjo ministri nuk ka pasur asnjë informacion për këto ngjarje sepse do të bënte parandalimin e tyre. Tha se personalisht ka pritur familjarët e të përfshirëve në këto ngjarje dhe se është ndjerë keq për këto ngjarje. Kosova ka bërë përpjekjet e saj përmes ambasadorit të saj në Shkup për të ndihmuar këto familje dhe procesin. Kurse për luftimin e terrorizmit, Kosova ka bërë progres në këtë aspekt, si dhe sa i përket parandalimit të shkuarjes së qytetarëve në Siri, këtë e ka thënë edhe raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit. Lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit nuk mund të fitohet kurrë, madje ajo nuk duhet të na bëjë që të ndihemi të sigurt. MPB-ja theksin e ka vënë te parandalimi i këtyre dukurive negative se sa te pasojat e tyre, duke ngritur padi penale, arrestimin e të dyshuarve dhe dërgimin e tyre në prokurori dhe gjykata. Pastaj kjo çështje është në kompetencë të prokurorive dhe gjykatave për ecurinë e mëtutjeshme. Kurse raportet e ndryshme ndërkombëtare (Raporti i progresit ose ndryshe Raporti për Kosovën dhe Raporti i departamentit të shtetit amerikan) e lavdërojnë punën e policisë së Kosovës në rastin e luftimit të këtyre veprave, ndërsa kanë vërejtje kryesisht sa i përket ndëshkimit të tyre. Kosova është radhitur në vendin e dytë në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, sa i përket edhe çështjeve tjera, siç është detyrimi dhe ushtrimi i prostitucionit, detyrimi i fëmijëve lypsarë nëpër rrugët e Kosovës. Gjatë muajit gusht të këtij viti, MPB-ja ka bërë një fushatë në shtatë rajonet e Kosovës me pjesëmarrje të forumeve të sigurisë së Kosovës në të gjitha komunat e saj. Kjo fushatë është përqendruar në animimin e forumeve komunale të sigurisë për sensibilizimin e shoqërisë në spektrin e gjerë social, jo vetëm politik dhe shoqëror, por në luftën kundër përdorimit të drogave dhe në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Ka qenë qëllimi që me predikuesit fetarë, si imamët, priftërinjtë, si dhe me drejtorët e shkollave, shoqërinë civile, gazetarët, etj., të bëhet më shumë për të ngritur vetëdijen për rreziqet nga këto dukuri negative. Pra, me fjalë tjera, tha se duhet të funksionojë i gjithë zinxhiri për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe përdoruesit e drogave. Ndërsa kur foli për vrasjet politike si një çështje e cila duhet të zgjidhet për ta hequr si dilemë me të cilën përballlet Kosova, ai mori një shembull personal të tij, duke thënë se një i burgosur në burgun e Dubravës e kishte marrë në telefon dhe i kishte kërkuar falje pasi që kishte dashur ta vriste, edhe pse atij nuk i kujtohej që dikush kishte dashur ta vriste, por gjatë atentatit mbi veturën e presidentit Rugovë, ai kishte qenë aty. Këtë shembull e mori si dëshmi se ai vetë, personalisht është i interesuar më së shumti që të zbardhej ky rast dhe rastet e tjera të vrasjeve politike në Kosovë.

Vjosa Osmani, ka diskutuar dhe komentuar rreth rasteve të dhunës në familje, si një nga rastet të cilat përmenden në MSA-në dhe në Raportet e progresit ose tash e tutje siç quhet Raporti për vendin ose për Kosovën, sipas së cilës është një çështje që duhet trajtuar në mënyrë profesionale nga policia e Kosovës. Rasti i fundit i raportuar për dhunën në familje e cila nga policia e Kosovës është cilësuar si çështje e traditave të mbrapshta, pa dashur për të përgjithësua gjithë policinë, por shpreson që të merren masa për trajnimin e këtyre zyrtarëve policorë lidhur me këto

çështje. Ndërsa ka pyetur nëse ka informacion rreth negociatave që janë duke bërë rreth klauzolës së suspendimit, çka saktësisht ajo nënkupton, në qoftë se çështja e liberalizimit kalon? Sepse është me rëndësi të dihet nga qytetarët e Kosovës se edhe nëse merret notë pozitive dhe votohet liberalizimi i vizave, kjo mund të suspendohet nëse nuk sillemi në bazë të kriterëve të përcaktuara për liberalizim. Kurse çështje tjetër, kishte të bënte me shtete konkrete, pasi që u përmend takimi me ministrin e Punëve të Brendshme të Austrisë, dhe mundësin e ndërtimit të një platforme të përbashkët në mes të Qeverisë dhe Kuvendit për të ndikuar të shtetet individuale të cilat ende mund të kenë mendim negative dhe për të punuar me ato shtet, jo vetëm për shkak të dy kriterëve të mbetura, por edhe për shkak të frikës për migrim që ju e përmendet. Në mënyrë të veçantë të punohet me disa shtet, si: Suedinë, Belgjikën, Gjermaninë, Spanjën dhe Francën. Ky Komision është duke u munduar të ndihmojë këtë proces përmes takimeve të ndryshme me parlamentarë të ndryshëm. Gjithashtu ajo kërkoi të informohej se cilat janë sfidat? Çka keni arritur me ministrat e brendshme dhe të kërkohet në qoftë se ka diçka që ky komision mundet me ndihmuar rreth liberalizimit të vizave? Kurse çështja e MSA-së sa i përket masave të pa kryera nga MPB-ja ka pyetur se cili ka qenë problemi i mos realizimit të tyre dhe cilat kanë qenë problemet që ka hasur kjo ministri për zbatimin e tyre? Dhe çështja tjetër, çështja e aplikimit për anëtarësim në INTERPOL, nëse është dorëzuar aplikacioni dhe cilat janë procedurat rreth këtij procesi?

Ministri Hyseni, i është përgjigjur pyetjeve dhe është pajtuar rreth komentit sa i përket dhunës në familje duke mos dashur të heq apo shtoi diçka. Ndërsa sa i përket klauzolës së suspendimit tha se procesi nuk është përmbyllur ende dhe nuk ka informacione të përditësuara se ku ndodhet. Mirëpo, rasti i Kosovës për liberalizim të vizave, pas radhës së vendeve tjera ka pasur efektet e veta dhe disavantazhe, sepse politika e BE-së karshi kësaj çështje është bazuar mbi mësimet e marra nga të tjerët. Prandaj Kosova është dashur të plotësojë kriteret më shumë se sa vendet të tjera të cilat kanë pasur për këtë proces, siç është Shqipëria apo Maqedonia, etj. Kurse sa i përket vendeve që u potencuan veç e veç, në rastin e Belgjikës, ministri i Punëve të Brendshme i cili dhe është zëvendëskryeministër ka thënë se Belgjika do ta përkrahë vendimin e Komisionit, në ditën e njëjtë kur është shpall rekomandimi. Kurse në Francë ka hezitime, prandaj është kërkuar të ketë takime edhe pse njëherë është takuar me ministrin e Punëve të Brendshme të Francës. Mirëpo ky hezitim për vizat nuk është shumë për arsye të kosovarëve, sa është për shkak të zgjidhjeve sistimore të lëndëve që ka sistemi i brendshëm francez. Po ashtu Holanda është një vend me të cilin duhet punuar dhe janë kërkuar takime me zyrtarë atje. Kurse ngecjet në disa pjesë të zbatimit të MSA-së janë si rezultat i disa arsyeve, të cilat nuk deshi të lëshohet në mënyrë specifike. Ndërsa sa i përket INTERPOL-it tha se me të është ruajtur një digresion diplomatik të komunikimit për hir të mos lëndimit të procesit, kurse tash ka ardhur koha që të bëhen publike, se tashmë Kosova ka aplikuar në INTERPOL. Aplikacioni i Kosovës do të duhej të shqyrtohej nga Komiteti ekzekutiv i INTERPOL-it, në mars ose në maj të këtij viti. Ky komitet është organ ekzekutiv i INTERPOL-it përbëhet nga trembëdhjetë anëtarë të vendeve anëtare të tij, dhe vendimet në këtë komitet zakonisht merren me votë të thjeshtë kur nuk ka konsensus. Aktualisht janë vetëm dymbëdhjetë anëtarë dhe i trembëdhjeti mungon dhe ende nuk është plotësuar, e cila ka krijuar një balancë të votave gjashtë me gjashtë nga të cilat janë po ashtu gjashtë vende të cilat e kanë njohur Kosovën dhe gjashtë që ende nuk e kanë njohur. Tha se personalisht ka shkuar në selinë e INTERPOL-it dhe ka takuar Sekretarin e saj. Ndërsa ideja është se kurdo që të hidhet në votim aplikacioni i Kosovës të mos dështojë. Si duket Sekretari i Përgjithshëm ka vendosur që këtë aplikacion të mos e procedojë për trajtim, sepse po të kalonte

në komitet ekzekutiv aplikimi do të votohej në Asamblenë e Përgjithshme të INTERPOL-it, i cili mbahet çdo vit dhe këtë vit mbahet në Bali të Indonezisë në muajin nëntor. Një fakt tjetër është se si pengës tjetër është aplikimi i Palestinës, dhe tha se dihet pse është e pa favorshme për Kosovën ky aplikim i tillë pa dashur të japë më shumë detaje.

Donika Kadaj-Bujupi, ka parashtruar disa pyetje të cilat po ashtu i ka dorëzuar me shkrim duke ju drejtuar MPB-së, si: Deri ku keni mbërritur me Planin e Zbatimit të strategjisë kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2015-2019? Si është situata në shifra krahasuar dhe vitin pasardhës? Cilat janë rrugët e trafikimit? Sa të proceduar (grupe, individë) ka pasur gjatë vitit 2016?

Në dokumentin zyrtar nuk është pikërisht pjesa që lidhet me MPB-në plani i veprimit, shtojca është bosh -http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_KOMBËTARE_KUNDËR_TRAFIKIMIT_ME_NJERËZ_NË_KOSOVË_2015-2019.pdf.

Sa është zyrtarisht numrin e shtetasve të Kosovës të cilët tashmë kanë dalë nga Kosova dhe janë nën statusin e azilantit, për periudhën 2015-2016? A janë implementuar masat për përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të autoriteteve kompetente për riintegrim? Pasi vetëm qytetarët të cilët kanë ikur nga Kosova para 28 korrikut, 2010 dhe të cilat kanë aplikuar brenda një kohe të caktuar mund të përfitojnë nga Fondi për Riintegrim, çka do të ndodhë me qytetarët të cilët kanë ikur pas 28 korrikut 2010, posaçërisht me numrin a madh të tyre të cilët kanë ikur gjatë vitit 2014-2015 të cilët po kthehen përsëri në Kosovë? Rezultatet e planit të veprimit në kapjen dhe procedimin e rrjetit të narko-trafikut? Cilat janë statistikatat e rasteve të proceduara këtë vit? Çfarë informatash ka Ministria e Brendshme sa i takon këtij lloji të trafikut në kufirin verior të vendit? Si realizohet kontrolli në ato zona? Raporti i Amnesty International ka paraqitur një seri shkeljesh shumë të rënda për policinë e Kosovës sa i takon ndërhyrjes së paligjshme në zyrat e Lëvizjes Vetëvendosje! Po ashtu raporti i Parlamentit Evropian i publikuar këtë pranverë konstaton se ka pasur dhunë jo proporcionale në atë ndërhyrje. Çfarë masash keni marrë për zinxhirin komandues të atij operacioni? A po procedohen? Deri ku ka mbërritur ministria që drejtoni në lidhje me aplikimin për anëtarësimin në Interpol? A e kanë kaluar verifikimin nga AKI-ja drejtori i policisë Shpend Maxhuni? Po drejtori i operacioneve? A kanë kaluar nga procesi i verifikimit qytetarët me kombësi serbe, që po i "integroni" në policinë e Kosovës? Për shumë prej tyre ka dyshime të pjesëmarrjes në vepra të rënda kundër shtetit të Kosovës dhe qytetarëve. Çfarë performance ka pasur këtë vit Departamenti i krimit ekonomik në policinë e Kosovës? Sa raste ka shqyrtuar dhe sa i ka procesuar në Prokurori? Çfarë është ndërmarrë lidhur me problemin e pajisjes me dokumentacion të shqiptarëve nga Lugina e Preshevës. Cilat masa janë zbatuar lidhur me Serbinë sa i takon menaxhimit të integruar të kufirit?

Ministri Hyseni, lidhur me pyetjet, tha se do të përgjigjet me shkrim. Mirëpo sa i përket raporteve ndërkombëtare, për dallim ku u tha se më shumë i besohet ministrit se raporteve ndërkombëtare, ai i beson edhe raportit të Amnesty International, dhe se inspektorati policor është marrë me atë raport dhe ai do të publikohet shpejt. Ky inspektorat është marrë edhe me 70 kallëzime penale të Vetëvendosjes në mënyrë specifike. Kurse për të gjitha pyetjet tjerat premtoi se do të dërgojë përgjigje me shkrim dhe me numrin e saktë të të dhënave.

Donika Kadaj-Bujupi, ndërhyri duke thënë se në këtë Komision është ftuar për raportim ministri i Punëve të Brendshme dhe kërkoj të dijë për afatin kohor të dërgimit të përgjigjeve me shkrim, për shkak se nga njëmbëdhjetë pyetje mori vetëm një përgjigje.

Ministri Hyseni, ka komentuar duke treguar se ai raporton rregullisht në Komisionin parlamentar për siguri në Kuvend, në detajet dhe në hollësi për punën e MPB-së, por sipas tij nga ky komision ka kërkuar të specifikohet se çka duhet të raportojë dhe kërkesa po ashtu është bërë në mënyrë specifike për raportim. Edhe pse tha se nuk e ka problem të raportojë dhe të takohet me deputetët për të diskutuar për shumë çështje të ndryshme, që shumicën prej tyre i ka miq.

Fatmir Xhelili, tha sa i përket luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si një prej kriterëve për liberalizimin e vizave, dhe potencoi, se disa nga strukturat policore janë të reja dhe ju duhet eksperiencë për të luftuar drejt dhe në mënyrë efektive krimin. Ndërsa parashtroi pyetjen nëse është bërë ndonjë analizë vlerësuese e këtyre drejtorive, pra që merren në mënyrë specifike me luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe shpëlarjes së parave. Pyeti se cili është niveli dhe cilësia e tyre? E nëse janë duke punuar për thithjen e fondeve dhe donacioneve nga faktori ndërkombëtar, përkatësisht vendeve mike për edukimin dhe pajisjet teknike të tyre? Apo duhet që shteti ynë të ndajë mjete buxhetore për funksionalizimin e tyre dhe ngritjen e cilësisë? Ndërsa në Raportin e progresit është potencuar ngadalësimi i implementimit të menaxhimit inteligjent i policisë, ndërsa pyeti nëse është duke vazhduar implementimi i metodës dhe edukimi i kuadrit policor lidhur me zbatimin e saj?

Ministri Hyseni, është përgjigjur në pyetjen e fundit sa i përket inteligjencës së policisë duke thënë se është duke vazhduar, ndërsa sa i përket luftimit të krimit dhe korrupsionit, në kontekst të përmbushjes si kriter për liberalizimin e vizave, tha se këtu më shumë bëhet fjalë për të dhëna ose statistika për rastet e lëndëve të përfunduara në gjykata, si dhe të njerëzve që janë dënuar për korrupsion dhe profilin e tyre. Ky kriter është delikat sepse nuk ka një mekanizëm matës për përmbushjen e tij, pasi që vetë procesi gjyqësor si i tillë mund të marrë kohë, ndoshta dhe me vite dhe nuk ka një instrument matës për këtë kriter. Ky kriter nuk bie shumë si kriter në ministrin e Punëve të Brendshme, thotë pa dashur shfaqësuar. Kurse po ashtu ka një perceptcion gjithashtu për korrupsionin në Kosovë, por ky perceptcion duhet të evidentohet me prova konkrete gjatë procedurës në gjykata.

Arben Gashi, ka diskutuar sa i përket çështjes së lirisë së lëvizjes së mallrave dhe të njerëzve, si një nga liritë themelore, dhe me këtë rast ka parashtuar dy pyetje. E para, ka konsideruar se me pajisjen e qytetarëve me targa provë dhe pamundësinë e pajisjes së tyre me targa të rregullta në Kosovë, është pamundësuar lëvizja e lirë e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Si dhe e dyta, është ndërlidhur me zyrtarin e lartë policor që është arrestuar në Serbi, ku ka pyetur nëse MPB-ja ka ndonjë akt juridik për të udhëzuar stafin e vet dhe policinë gjatë udhëtimit në vendet më pak miqësore që të marrin masa për lëvizjen e tyre në ato vende ose të evitimit të udhëtimit të tyre. Apo, nëse nuk ekziston një akt i tillë të mendohet që të nxirret dhe të evitohen rastet apo ngjarjet e tilla të zyrtarëve të caktuar, ndoshta edhe për institucionet tjera?

Ministri Hyseni, tha se për targat provuese është ma mirë një e keqe afatshkurtër se një e keqe afatgjatë, dhe se asnjëherë në zyrën e tij nuk ka pranuar një dokument për të nënshkruar për një proces tenderues rreth tabelave deri në ditën e djeshme. Mirëpo, MPB-ja ka dashur që të sigurohet mirë lidhur me këtë tender dhe të mos ketë ndonjë defekt të mundshëm. Në MPB është kthyer raporti nga OSHP-ja dhe ndoshta është rasti i tretë apo i katërt që ky organ është miratuar me votë unanime nga OSHP për këtë tender. Kurse brenda 30 ditësh kompania fituese do të prodhojë numër të bollshëm të tabelave dhe qytetarët do të pajisen me ato tabela. Policia e Kosovës nuk ka ndonjë protokoll të brendshëm që udhëzon stafin e vet për rrugën të cilën duhet

ta ndjekë për të udhëtuar jashtë vendit. Ka një opsion që kur të merret pushimitë njoftohet eprori se ku po shkon (për pushimin), por jo dhe rrugën ka do ta ndjekë gjatë udhëtimit. MPB-ja nga ky rast ka lëshuar një udhëzim, si sugjerim pasi që nuk mund të jetë i obligueshëm, që këta zyrtarë të policisë të evitojnë udhëtimin nëpër Serbi. Po ashtu tha se janë në koordinim të plotë me disa ministri (siç është Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme) lidhur me rastin e arrestimit të këtij zyrtari policor në Serbi që të kthehet në Kosovë, i cili kur është arrestuar ka qenë në pushim dhe duke udhëtuar për në një shtet tjetër.

Time Kadriaj, pati pyetje shtesë për ministrin: kur do të hartohet projektligji për pensionimin e parakohshëm të policisë dhe kur do të procedohet për miratim në Kuvend?

Ministri Hyseni, duke ju përgjigjur pyetjes, tha se ky projektligj tashmë është hartuar nga MPB-ja dhe aktualisht ndodhet te Ministria e Financave (MF) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) për opinion. Pra, është dërguar me qëllim të ikjes së çdo politizimi të mundshëm të pensionimit të parakohshëm të policisë, ndodhet për shqyrtim në çështjet e financave dhe kontrollit të FMN-së, që sipas tyre nuk duhet t'u jepet para shtesë këtyre personave, përveç pensionit që e meritojnë. Kurse kostoja fillestare është shumë e lartë për këtë proces, prandaj është shkuar me gradacion të bëhet ky pensionim, që do të thotë se në vitin e parë, përkatësisht nga 1 janari i viti 2017 të pensionohen të gjithë ata të cilët arrijnë moshën prej 60 vitesh, kurse nga 1 janari i viti 2018 pensionohen të gjithë ata të cilët arrijnë moshën prej 55 vitesh. Pra, ai shpreson që gjatë këtij viti ky ligj të miratohet në Kuvend. Prandaj ideja është që zyrtarët policor të këtyre moshave të pensionohen parakohshëm dhe përqindjen ende nuk është definitive, sidomos beneficinet ose pagesa pas arritjes së moshës së pensionit të rregullt.

Me këtë rast dhe përfundon raportimi i ministrit.

4. Të ndryshme

Pastaj, **kryetarja** e Komisionit prezantoi Jeta Krasniqin dhe Artan Muratin, si dhe projektin e tyre të mbështetur nga Zyra zvicerane në Kosovë lidhur me monitorimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, dhe ia dha fjalën për prezantim.

Jeta Krasniqi, menaxhere e projektit në KDI, e cila prezantoi projektin e KDI-së dhe rritjen e rolit monitorues të Kuvendit në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Tregoi për nënshkrimin e një memorandumit të bashkëpunimit në mes të Kuvendit dhe KDI-së për ofrimin e asistencës dhe bashkëpunimit dhënë deputetëve dhe komisioneve parlamentare. Tha se është zgjedhur ky komision për shkak të rolit të tij që ka në këtë proces dhe në Kuvend. Gjithashtu u tregua për përgatitjen e raportit të tyre për monitorimin e Qeverisë për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe disa rezultate të cilat kanë dalë si rezultat i anketave të organizuar në terren. Ata u shprehen të gatshëm për ofrimin e mbështetjes dhe asistencës për përgatitjen e pyetjeve parlamentare, hulumtimeve parlamentare, për komisione parlamentare dhe grupeve parlamentare gjithashtu.

Ndërsa, anëtarët e këtij Komisioni shprehen gatishmërinë për bashkëpunim lidhur me ofrimin e mbështetjes si në hulumtime parlamentare dhe të praktikave të ndryshme të vendeve tjera të përgatitura nga KDI-ja, përkatësisht për monitorimin e zbatimit të ligjeve që ndërlidhen me

integrimin evropian të Kosovës, monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë, etj.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini